

VENDIM
Nr. 46, datë 31.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 518, DATË 20.9.2017, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË NJË PJESE TË GODINËS KU USHTRON VEPRIMTARINË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT, PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT, INSTITUCION I RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, I PARASHIKUAR NGA LIGJI NR. 84/2016”, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 497, DATË 13.9.2017, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË ISH-GODINËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE, NGA MINISTRIA E KULTURËS KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE KOMISIONERËVE PUBLIKË, INSTITUCIONE TË RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR. 84/2016”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10, 13, 14 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titull dhe në pikën 1, të vendimit nr. 518, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... Kolegjin e Posaçëm të Apelit, institucion i rivlerësimit ...” zëvendësohen me “... Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit ...”.

2. Në titull dhe në përmbajtje të vendimit nr. 497, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... dhe Komisionerëve Publikë ...” shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës dhe Komisionerët Publikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama